




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Komisioni i Përkohshëm për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për Mbështetje Financiare Publike të Projekteve të OJQ-ve (Klubeve Sportive)

Në mbështetje të dispozitave të nenit 42, 43, 44, 46, 47, 48, 88, 89, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Nenit 16 të Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, bazuar në Thirrjen Publike Sh.13/Nr.7718, datë 26.03.2026, për mbështetje financiare publike të projekteve të OJQ-ve, si dhe vendimin e Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të (Klubet Sportive), Komisioni merr këtë:

V E N D I M
PËR PËRCAKTIMIN E APLIKANTËVE TË KUALIFIKUAR

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet aplikanti i kualifikuar që përfiton mbështetje financiare publike, sipas renditjes së pikëve:

Nr	Nr. aplikacioni	Emri i OJQ-së	SELIA	Shuma e mjeteve	Emri i projektit / programit	Pikët
1	Nr.pr.10109 /26	KA "ROGANA"	Roganë	10,000.00€	"Ngritja e Performancës dhe Aktiviteteve vendore dhe Ndërkombëtare"	90
2	Nr.pr.8507 /26	KF "KIKA"	Hogosht	10,000.00€	"Mbarvajtja e Garave Kampionale gjatë vitit 2026 të KF KIKA"	90
3	Nr.pr.9559 /26	KF "DARDANA10"	Kamenicë	9,000.00€	"Mbarvajtja e Garave Kampionale në ligen e tretë dhe grupmoshat të reja për vitin 2026"	85
4	Nr.pr.9469 /26	K-FUTBOLLIT "BESA 1978"	Shipashnicë Epërme	3,000.00€	"Përmisimi i kushteve dhe mbarvajtja e garave"	70
5	Nr.pr.10121 /26	K-ALPIN "ROGANA"	Roganë	2,800.00	"Zhvillimi i kapaciteteve sportive dhe rekreative për promovimin e turizmit Malore dhe natyrës"	70
6	Nr.pr.10280 /26	K-VOLEJBOLLIT "FENIKS" F	Kamenicë	2,500.00€	"Përmirësimi dhe aftësimi i femijeve në aspektin profesional sportiv"	68
7	Nr.pr.10282 /26	K-VOLEJBOLLIT "FENIKS" Meshkujt	Kamenicë	2,300.00€	"Përmirësimi dhe aftësimi i femijeve në aspektin profesional sportiv"	65
8	Nr.pr.9940 /26	K-SHAHUT "DARDANA"	Kamenicë	900.00€	"Aktivitete garuese dhe organizative të Klubit"	58

9	Nr.pr.9542 /26	SHPRS 'MLYSHI'	Kamenicë	600.00€	"Mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e rekuizitave sportive dhe ushqimin për ndeshje zyrtare të organizuara nga FPSRK-ja"	55
---	-------------------	----------------	----------	---------	--	----

Neni 2

Obligohet OJQ (Klubet Sportive) në Kamenicë që t'i përmbahet aplikacionit, në veçanti planit të veprimit dhe aktiviteteve të parapara në aplikacion.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Financa dhe Buxhet, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ndërsa mbikëqyrjen e zbatimit e bën Kryetari i Komunës.

Neni 4


Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga anëtarët e Komisionit dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komunës së Kamenicës.


KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 5 (pesë) ditësh pune nga dita e pranimi të vendimit. Ankesa i dorëzohet Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ankesave për Ndarjen e Subvencioneve, përmes Qendrës për Shërbim të Qytetarëve.

Vendimi t'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Zyrës për Informim
- Përfituesit: OJQ-ve (Klubeve Sportive)– Kamenicë
- Drejtorisë për Financa dhe Buxhet
- Qendrës për Shërbim të Qytetarëve (Arkivit)

Komisioni vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve:

Shehat Rrudhani 

Azemine Maliqi 

Edon Canaj 

Lavdim Klaiqi 

Liridon Rexhepaj 

Ajshe Thaqi 